



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1022/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Zejnepe Osmani kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Zejnepe Osmani kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 11:55, ka pranuar një apel nga Zejnepe Osmani kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Klinë, me të cilin thekson se asaj i mungojnë votat familjare dhe se dyshon se ato i janë bartur një kandidati tjetër nga subjekti politik LDK.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apelleses gjeti se, apellesja nuk ka ofruar asnjë provë për të dëshmuar pretendimet e saj ankimore në lidhje me mungesën e votave. Prandaj Paneli apelin e tij e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat

ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

ZL.Anr.1022/2017 me datën 12.11.2017.



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.